



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1681 Prot

Tiranë, më 13.11.2020

**THIRRJA PËR PARAQITJEN E SHPREHJES SË INTERESIT PËR  
KANDIDATË NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

**Drejtuar: PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS PARË**

**PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

**PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR  
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Pas vendimeve të ardhura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në të cilat është vendosur shkarkimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit, njëherazi dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë hapur dy vende vakante në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Anëtarët e shkarkuar ishin të zgjedhur një nga radhët e prokurorëve të prokurorive të shkallës së parë dhe një nga radhët e prokurorëve të prokurorive të apeleve.

Përsa më sipër, në bazë të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ftojmë prokurorët e interesuar nga prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë dhe prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, duke përfshirë edhe prokurorët e prokurorisë së posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe që plotësojnë kriteret sipas ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të sjellin dokumentet pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Të interesuarit krahas kërkesës me shkrim, të bashkëlidhin dhe dokumentet e mëposhtme:

a) jetëshkrimin e përditësuar;

- b) deklaratat individuale të prokurorëve që i kanë mbështetur, të nënshkuara rregullisht; c) formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që propozojnë të ndjekin në qoftë se zgjidhen;
- d) një deklaratë individuale të nënshkuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk kanë qenë anëtarë ose bashkëpunëtorë të shërbimeve të inteligjencës përpara 2 korrikut 1991;
- dh) një deklaratë individuale të nënshkuar, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, se nuk janë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve sekrete;
- e) informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungj/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetuesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.
- ë) listën e personave të lidhur, sipas kuptimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”
- g) Formularin e Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

Të interesuarit kanë **15 ditë** kohë nga shpallja e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit.

**PROKURORI PËRGJITHSHËM**

**OLSIAN ÇELA**

